



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Anketas e Fuqisë Punëtore 2016





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Anketa e Fuqisë Punëtore 2016



Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e botimit: Maj, 2017

© : Agjencia e Statistikave të Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së
në internet <http://ask.rks-gov.net/>

Parathënie

Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP) në Kosovë ofron të dhëna statistikore mbi indikatorët statistikorë të tregut të punës dhe mundëson krahasimin e tyre me vitet paraprake. Anketa e Fuqisë Punëtore përfshin si mostër 1030 Qarqe Regjistruese (QR) në tërë territorin e Kosovës.

Raporti mbi AFP-në, në vitin 2016 përmban të dhëna mbi punësimin dhe papunësinë sipas moshës, gjinisë, gjendjen e punësimit, aktiviteteve ekonomike, profesioneve dhe fushave të tjera të tregut të punës.

Në vitin 2016, shkalla e punësimit është 28.0 %, shkalla e papunësisë është 27.5 % ndërsa shkalla e jo aktivitetit është 61.3 %.

Të dhënat e AFP-së tregojnë që përqindja e personave të punësuar me orar të pjesshëm për vitin 2016, është 6.0%. Vetëpunësimi (si përqindje e të punësuarve) për vitin 2016 është 22.1 %. Përqindja e të punësuarve në punë të paqëndrueshme (personat, që janë të vetëpunësuar dhe nuk kanë punonjës dhe ata që punojnë pa pagesë në një biznes familjar) ishte 22.9%. Tregtia, prodhimi, ndërtimtaria dhe arsimit vazhdojnë të punësojnë pothuaj gjysmën e personave të punësuar.

Sa i përket pjesëmarrjes në fuqinë punëtore që është 38.7 % në këtë periudhë, numri i femrave që i përkasin fuqisë punëtore ishte 18.6 % ndërsa meshkuj ishte 58.3 %.

Shkalla e papunësisë tek të rinjtë është 52.4%.

Papunësia afatgjate e të rinjve (15-19), që kanë qenë të papunë për më shumë se 12 muaj për këtë vit është 39.7 %.

Përqindja e të rinjve që nuk janë të punësuar, as në shkollim, as në trajnim – NEET (të intervistuarit e moshës 15-24 vjeç), është 30.1 %.

Me këtë rast, ASK-ja falënderon pjesëmarrësit dhe akterët e tjerë, e posaçërisht stafin e angazhuar në realizimin e AFP-së 2016. Njëkohësisht, i bën me dije të gjithë përdoruesit e statistikave zyrtare se ASK-ja, brenda mundësive buxhetore, në vazhdimësi po bën përpjekje për ngritjen e kapaciteteve për të publikuar statistika të qëndrueshme dhe sa më cilësore.

Në bazë të Ligjit të Statistikave Zyrtare Nr.04/L-034, Agjencia e Statistikave të Kosovës është përgjegjëse për prodhimin e statistikave zyrtare në Republikën e Kosovës, prandaj, gjatë shfrytëzimit të këtyre të dhënave, duhet të citohet burimi.

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe ato të dërgohen në adresën elektronike: social@rks-qov.net

Publikimin përgatitën:

Avni Kastrati	-	U.D. Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale
Bujar Hajrizi	-	Shef i Sektorit
Bedrije Demaj	-	Zyrtare e lartë
Besarta Thaçi	-	Zyrtare

Maj, 2017

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së
Isa Krasniqi

Hyrje

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), ka filluar realizimin e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) në vitin 2001, duke vazhduar si anketë vjetore deri në vitin 2009. Për shkak të përgatitjes së regjistrimit të popullsisë, Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP) nuk u realizua në vitin 2010 dhe 2011.

Nga viti 2012 Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP) zhvillohet sipas metodologjisë së Eurostatit si anketë e vazhdueshme (52 javë kalendarike - javë referuese), si dhe:

- Pyetësi i përmirësuar (duke vazhduar me respektimin e udhëzuesve të Eurostat-it)
- Korniza e re e mostrës (bazuar në Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe banesave të vitit 2011 në Kosovë)
- Nën-mostra longitudinale, ku çdo ekonomi familjare e përzgjedhur intervistohet katër herë (një herë në tre muaj, ku hera e parë në ekonominë familjare të përzgjedhur është Anketim dhe tri intervistat tjera si Rianketime ku përcillen ndryshimet eventuale të Indikatorëve, në atë ekonomi familjare të përzgjedhur prej tremujorit në tremujorin tjetër).
- Intervistimi i ekonomive familjare është realizuar me anë të laptopit, përkatësisht përmes metodës CAPI – Intervista Personale me Asistencë Kompjuterike, e cila mundëson gjenerimin e të dhënave më shpejt se sa përmes metodës PAPI, përkatësisht metodës së intervistimit tradicional të mbledhjes së të dhënave me letër dhe laps, të cilat futen më pas në kompjuter.

Objektivat kryesorë të AFP-së janë grumbullimi i informatave kryesisht për anën e ofertës së tregut të punës, d.m.th. informatave mbi ata që punojnë apo që janë aktivë në kërkim të një pune.

Falenderim

Nga viti 2014, AFP-ja realizohet me buxhetin e ASK-së. Shprehim mirënjohjen tonë ndaj punës të zyrave rajonale të ASK-së, të cilët kanë mbikëqyrur punën në terren, dhe ndaj familjeve, që kanë ndarë kohën e tyre dhe kanë ofruar të dhëna duke ndihmuar në këtë mënyrë mbledhjen e këtyre informacioneve të detajuara.

Shkurtesat

AFP	-	Anketa e Fuqisë Punëtore
ONP	-	Organizata Ndërkombëtare e Punës
ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	-	Bashkimi Evropian
NACE	-	Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike
ISCO	-	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Profesioneve
QR	-	Qark Regjistruar
NEET	-	Të rinj që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollën apo trajnim

Përmbajtja

	Faqe
Parathënie	1
Hyrje	2
Falenderim.....	3
Shkurtesat	4
Definicione.....	7
Treguesit kryesorë	10
Tab. 1: Indikatorët kryesorë të tregut të punës	12
1. Punësimi.....	13
1.1: Punësimi sipas gjinisë.....	13
1.2: Punësimi sipas grupmoshës dhe nivelit arsimor.....	13
Tab.1.1: Numri i të punësuarve dhe shkalla e punësimit sipas gjinisë dhe grupmoshës.....	14
Tab. 1.2: Punësimi sipas nivelit arsimor	14
Tab. 1.3: Niveli më i lartë arsimor sipas llojit të punëdhënësit (15-64).....	15
1.3: Statusi i punësimit.....	15
Tab. 1.4: Statusi i punësimit sipas gjinisë (%)	15
1.4: Punësimi i paqëndrueshëm.....	15
Tab. 1.5: Punësimi i paqëndrueshëm sipas gjinisë	16
Tab. 1.6: Punësimi i paqëndrueshëm sipas profesionit dhe gjinisë	16
Tab. 1.7: Punësimi i paqëndrueshëm sipas nivelit arsimor dhe gjinisë	17
1.5: Llojet e kontratave.....	17
1.6: Punësimi sipas aktiviteteve	17
Tab. 1.8: Punësimi sipas aktiviteteve dhe gjinisë (në mijëra)	18
Tab. 1.9: Punësimi sipas aktiviteteve dhe gjinisë (në %)	18
1.7: Punësimi sipas profesioneve.....	19
Tab. 1.10: Punësimi sipas profesioneve dhe gjinisë (në %)	19
1.8: Modelet e punës	20
Tab. 1.11: Arsyet e të punuarit me orar të pjesshëm sipas gjinisë (%)	20
Tab. 1.12: Punësimi sipas orëve të punës në javë dhe sipas gjinisë	20
Tab. 1.13: Numri mesatar i orëve të punuara në javë sipas llojit të punëdhënësit dhe gjinisë	21
Tab. 1.14: Modelet e punësimit sipas gjinisë.....	21
1.9: Paga mujore neto.....	22
2. Papunësia.....	23
2.1: Papunësia sipas gjinisë.....	23
Tab. 2.1: Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas gjinisë	23
2.2: Papunësia sipas grup moshës dhe nivelit arsimor.....	24
Tab. 2.2. Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas gjinisë dhe grup moshës.....	24
Tabela 2.3. Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas nivelit arsimor dhe gjinisë	24
2.3: Papunësia tek të rinjtë.....	25
Tab. 2.4: Përqindja e të rinjve të papunë në papunësinë e përgjithshme dhe shkalla e papunësisë tek të rinjtë sipas gjinisë	25
Tab. 2.5: Shkalla e papunësisë së të rinjve ndaj të rriturve, sipas gjinisë	25
2.4: Kohëzgjatja e papunësisë	25
Tabela 2.6: Kohëzgjatja e papunësisë për më shumë se një vit sipas grup moshës dhe gjinisë (%).....	25
Graf. 2.2. Kohëzgjatja e papunësisë për më shumë se një vit sipas grup moshës dhe gjinisë (%).....	26
3. Pjesëmarrja në fuqinë punëtore	27
Graf. 3.1: Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas gjinisë	27

Tab. 3.1: Fuqia punëtore dhe shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas gjinisë dhe grupmoshës	28
4. Personat joaktivë	29
Graf 4.1: Shkalla e pjesëmarrjes jo aktive sipas gjinisë	29
4.1: Të rinjtë joaktivë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollimin ose trajnim (NEET) ..	30
Tab 4.1: Të rinj që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollë ose trajnim (NEET) sipas gjinisë	30
5. Shkallët e varësisë demografike dhe ekonomike	31
Tab 5.1: Shkallët e varësisë demografike	31
Tab 5.2: Shkallët e varësisë ekonomike	31

Definicione

Popullsia në moshë pune përfshin personat e moshës 15 deri 64 vjeçare. Kjo masë përdoret për të dhënë një vlerësim të numrit të përgjithshëm të punonjësve potencialë brenda një ekonomie.

Fuqia punëtore përbëhet nga personat e punësuar dhe personat e papunë, sipas përkufizimeve të sakta, të paraqitura mëposhtëm. Personat joaktivë nuk konsiderohen pjesë e fuqisë punëtore.

1. **Të punësuar:** personat, të cilët gjatë javës referente kanë bërë ndonjë punë për pagesë, fitim ose përfitim familjar, në të holla ose në natyrë, ose ata që mungonin përkohësisht në punën e tyre.
2. **Të papunë:** personat, të cilët gjatë javës referente:
 - Ishin pa punë, d.m.th. nuk ishin të punësuar me pagesë ose të vetëpunësuar;
 - Aktualisht ishin të gatshëm për punë, d.m.th. ishin të gatshëm të fillojnë punë me pagesë ose vetëpunësim brenda dy javësh; dhe
 - Kërkonin punë, d.m.th. kishin ndërmarrë hapa specifikë gjatë katër javëve të fundit në kërkim të punësimit me pagesë ose vetëpunësimit.
3. **Persona joaktivë:** personat, të cilët gjatë periudhës referente nuk ishin as të punësuar ose të papunësuar.

Klasifikimi i popullsisë në këto tri kategori të lartpërmendura varet nga aplikimi i parimit të aktivitetit – çfarë ka bërë personi në të vërtetë gjatë javës referuese - dhe një grup rregullash prioritare mbi aktivitetin, që i japin përparësi punësimit mbi papunësinë dhe papunësisë mbi joaktivitetin ekonomik. Klasifikimi gjithashtu varet nga të kuptuarit e qartë se cilat aktivitete konsiderohen si “punësim”.

Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është përqindja e popullsisë në moshë pune e një vendi, që angazhohet në mënyrë aktive në tregun e punës (të punësuar apo të papunësuar). Raporti i fuqisë punëtore (të punësuarit dhe të papunët) ndaj popullsisë në moshë pune, i shprehur si përqindje është:

$$\text{Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore} = \frac{\text{Të punësuar} + \text{Të papunë}}{\text{Popullsia në moshë pune}} \times 100$$

Shkalla e jo-aktivitetit është përqindja e popullsisë në moshë pune e një vendi, që nuk bënë pjesë në fuqinë punëtore (as të punësuar as të papunë). Kur mblidhen së bashku, shkalla e jo-aktivitetit dhe ajo e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore japin rezultatin 100 për qind.

Raporti i punësimit ndaj popullsisë, i njohur edhe si shkalla e punësimit, është përqindja e popullsisë në moshë pune e një vendi, që është e punësuar.

$$\text{Raporti i punësimit ndaj popullsisë} = \frac{\text{Popullsia e punësuar}}{\text{Popullsia në moshë pune}} \times 100$$

Shkalla e papunësisë është përqindja e fuqisë punëtore, që nuk është e punësuar. Fuqia punëtore përcaktohet si bazë për këtë indikator dhe jo popullsia në moshë pune.

$$\text{Shkalla e papunësisë} = \frac{\text{Të papunë}}{\text{Fuqi punëtore}} \times 100$$

Punonjës të dekurajuar janë personat që nuk kanë punë, të cilët aktualisht janë të gatshëm për punë, por që kanë hequr dorë së kërkuari punë sepse besojnë se nuk mund të gjejnë punë. Kjo kategori e personave të dekurajuar përfshihen në kategorinë e popullsisë joaktive.

Papunësia e të rinjve i referohet papunësisë së personave të moshës 15-24 vjeç.

NEET përbëjnë pjesën e të rinjve(15-24 vjeç), që nuk janë as të punësuar, nuk ndjekin as shkollim dhe as trajnim.

Punësimi i paqëndrueshëm i referohet personave të vetëpunësuar, që nuk kanë të punësuar ose punëtorëve të papaguar familjarë. Këta lloj të punësuarish kanë më pak gjasa të kenë marrëveshje formale pune dhe ka më shumë gjasa që këtyre t'u mungojnë kushtet e përshtatshme për punë.

Diagrami i mëposhtëm, ilustron kriteret, që përdoren për klasifikimin e popullsisë në moshe pune si të punësuar, të papunë, apo joaktive.

Grafiku 1: Klasifikimi i fuqisë punëtore në Anketën e Fuqisë Punëtore të Bashkimit Evropian

Person i moshës 15 vjeç e më shumë që jeton në një ekonomi familjare private


Personi ka bërë ndonjë punë për pagesë ose fitim gjatë javës referente

Personi nuk ka punuar por ka pasur një punë ose biznes prej të cilit ka munguar në javën referente

Punëtor familjar i papaguar

Person i moshës 15-74 vjeç, i cili nuk ka kërkuar punësim sepse puna e cila do të fillojë brenda 3 muajve tanimë ishte gjetur

Person i moshës 15-74 vjeç, që kërkonte punësim




Treguesit kryesorë

Grafikoni 2 paraqet një përmbledhje të gjendjes së tregut të punës të popullsisë së Kosovës duke u bazuar në Anketën e Fuqisë Punëtore të vitit 2016. Ndër rezultatet kryesore të AFP-së për vitin 2016, siç paraqitet në grafikonin 2 dhe elaborohet më tej në këtë raport, janë:

- Pothuajse dy të tretat e popullsisë së Kosovës është në moshë pune (15-64 vjeç). Pritet që popullsia në moshë pune të rritet shpejt gjatë dekadës së ardhshme pasi Kosova është ndër vendet me popullsinë më të re në Evropë.
 - Nga popullsia në moshë pune, 61.3 % nuk janë ekonomikisht aktivë, që do të thotë se ata nuk janë të punësuar dhe nuk kanë qenë aktivë në kërkim të punësimit gjatë katër javëve të kaluara dhe/ose nuk janë të gatshëm të fillojnë punë brenda dy javësh.
 - Nga 38.7 % e popullsisë, që është ekonomikisht aktive, 27.5 % (126,070 persona) janë të papunë. Kjo do të thotë se 72.5% (331,761) e personave ekonomikisht aktivë janë të punësuar, duke krijuar një raport punësimi ndaj popullsisë (shkalla e punësimit) prej 28.0 %.
 - 61.3 % e popullsisë në moshë pune, që është joaktive.
 - Ekzistojnë dallime të mëdha gjinore në tërë tregun e punës.
 - Pothuaj një në pesë (18.6 %) femra në moshë pune janë aktive në tregun e punës, krahasuar me rreth tri te pestat (58.3 %) e meshkujve në moshë pune.
 - Në mesin e personave në fuqinë punëtore, papunësia është më e lartë për femrat se sa për meshkujt (31.8 % krahasuar me 26.2 %).
 - Shkalla e punësimit në mesin e femrave në moshë pune është vetëm 12.7 %, krahasuar me 43.0 % për meshkujt.
 - Kjo shkallë shumë e ulët e papunësisë te femrat rrjedh nga kombinimi i pjesëmarrjes shumë të ulët në fuqinë punëtore dhe papunësisë së lartë.
 - Femrat ishin të punësuar kryesisht në sektorët e arsimit, tregtisë dhe të shëndetësisë (51.3 % e femrave të punësuar). Meshkujt ishin kryesisht të punësuar në sektorët e prodhimit, ndërtimtarisë dhe tregtisë (duke punësuar me 44.3 % të meshkujve të punësuar).
 - Papunësia tek të rinjtë është shumë e lartë në Kosovë
 - Në vitin 2016, të rinjtë në Kosovë kishin gjasa dy herë më shumë të jenë të papunë krahasuar me të rriturit. Në mesin e personave të moshës 15-24 vjeçare dhe në fuqinë punëtore, 52.4 % ishin të papunë.
- Papunësia është më e lartë te femrat e reja (65.4 %) se te të rinjtë meshkuj (47.2%).
- Një e treta (30.1 %) e personave të moshës 15 deri 24 vjeçare në Kosovë nuk ishin në shkollim, punësim apo trajnim (NEET). Kjo shifër është 34.2 % për femrat e reja krahasuar me 26.5 % për të rinjtë meshkuj.

- Pjesa më e madhe e atyre që janë të punësuar raportojnë të punojnë me orar të plotë.
- 94.0 % e të intervistuarve raportuan se punojnë me orar të plotë në punën e tyre kryesore.
- Arsyet e të punuarit me orar të pjesshëm dallojnë midis dy gjinive, pasi gratë, duke marrë përsipër më shumë rolin e kujdesit brenda familjes, reduktojnë orët në dispozicion për punësim.
- Arsyeja numër një për meshkujt pse nuk punojnë me orar të plotë, ishte mungesa e një pune me orar të plotë.
- 22.9 % e personave të punësuar i përkiste kategorisë së punësimit të paqëndrueshëm. Kjo do të thotë se ata ose janë të punësuar në biznesin e tyre (punëtorë për llogari vetanake), ose kontribuojnë në një biznes familjar (të paguar ose të papaguar).
- Vetëm 29.5 % e personave të punësuar kishin kontratë të përhershme në punën e tyre kryesore, ndërkohë që 70.5 % kishin kontratë të përkohshme, pa dallime sinjifikante midis meshkujve dhe femrave. Personat, që kishin kontrata të përkohshme, u pyetën se pse kishin këtë lloj kontrate dhe 98.5 % e të intervistuarve raportuan se nuk kishte kontratë tjetër në dispozicion.
- Pagat neto të shumicës së punonjësve ishin midis 300 € deri 400 € në muaj. Janë vërejtur dallime shumë të vogla gjinore.

Graf. 2: Klasifikimi i tregut të punës për popullsinë e Kosovës, 2016



Tab. 1: Indikatorët kryesorë të tregut të punës

Indikatorët kryesorë të tregut të punës (%)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore	58.3	18.6	38.7
Shkalla e joaktivitetit	41.7	81.4	61.3
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit)	43.0	12.7	28.0
Shkalla e papunësisë	26.2	31.8	27.5
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	47.2	65.4	52.4
Përqindja e të rinjve NEET në popullsinë e të rinjve (15-24 vjeç)	26.5	34.2	30.1
Përqindja e punësimit të paqëndrueshëm ndaj punësimit të përgjithshëm	24.1	18.8	22.9


1. Punësimi

1.1: Punësimi sipas gjinisë

Nga e gjithë popullsia në moshë pune, 28.0% ishin të punësuar. Shkalla e punësimit ishte më e lartë për meshkuj se sa për femra: 43.0 % të meshkujve në moshë pune ishin të punësuar krahasuar me 12.7 % të femrave po ashtu në moshë pune.

Krahasuar me AFP-së 2015 në Kosovë, kemi rritje të shkallë së punësimit me 2.8 %, ku kjo rritje te meshkujt ishte 4.3 % përderisa te femrat është 1.2%.

Graf. 1.1: Shkalla e punësimit sipas gjinisë



1.2: Punësimi sipas grupmoshës dhe nivelit arsimor

Shkalla e punësimit nëpër grup moshë ishte më e larta në mesin e personave të moshës mes 35-44 vjeç (38.5 %) dhe më e ultë në mesin e të rinjve (15-24 vjeç) (10.1 %).

Shkalla e punësimit te femrat për grup moshat 25-44 vjeç sillet nga 17.0% në grup moshën 25 - 34 vjeç ku ka rënie 0.1 % në grup moshën 35-44 vjeç (16.9%). Ndërsa femra të punësuar në grup moshën e re (15-24 vjeç), ishin vetëm 4.4% derisa në grup moshën e vjetër (55-64 vjeç) ishin 10.0 %.

Tek meshkujt (Tabela 1.1), shkalla e punësimit ishte më e larta për grup moshën 35 deri 44 vjeç (61.8%), dhe më e ultë për të rinjtë (15.2%).

Tab.1.1: Numri i të punësuarve dhe shkalla e punësimit sipas gjinisë dhe grupmoshës

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PUNËSIMI (NË MIJËRA)			
15-24	27.7	7.2	34.9
25-34	64.4	20.1	84.5
35-44	67.2	20.0	87.1
45-54	60.3	19.4	79.7
55-64	37.8	7.7	45.5
15-64	257.4	74.4	331.8
Raporti punësim ndaj popullsisë (%)			
15-24	15.2	4.4	10.1
25-34	48.3	17.0	33.6
35-44	61.8	16.9	38.5
45-54	61.7	17.7	38.4
55-64	49.4	10.0	29.6
15-64	43.0	12.7	28.0

Tabela 1.2 tregon që sa më i lartë të jetë shkollimi aq më e lartë do të jetë mundësia për të u punësuar (57.1%).

Tab. 1.2: Punësimi sipas nivelit arsimor

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PUNËSIMI (NË MIJËRA)			
Pa shkollë	0.3	0.4	0.8
Fillor	45.9	14.1	60.0
Arsim i mesëm profesional	93.3	19.3	112.5
Shkollë e mesme gjimnazi	61.8	11.2	73.1
Terciar	56.1	29.3	85.4
Gjithsej	257.4	74.4	331.8
SHKALLA E PUNËSIMIT (%)			
Pa shkollë	4.3	2.0	2.6
Fillor	28.5	5.0	13.6
Arsim i mesëm profesional	46.9	17.3	36.2
Shkollë e mesme gjimnazi	43.1	10.4	29.1
Terciar	64.9	46.5	57.1
Gjithsej	43.0	12.7	28.0

Tab. 1.3: Niveli më i lartë arsimor sipas llojit të punëdhënësit (15-64)

Kosovë	Sektori publik, qeveria	Ndërmarrje në pronësi shtetërore	Kompani private	Individuale private
NIVELI MË I LARTË ARSIMOR (%)				
Pa shkollë	0.1	0.0	0.1	0.0
Fillor	4.9	5.2	17.6	29.1
Arsim i mesëm profesional	26.4	22.1	39.4	40.7
Shkollë e mesme gjimnazi	12.2	29.6	24.2	22.1
Terciar	56.4	43.0	18.8	8.1
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0

Tabela 1.3 tregon që kërkesat për vende pune janë më të larta për pozita qeveritare, ku mbi gjysma e të gjithë të punësuarve (56.4%) e kanë të përfunduar arsimin e lartë.

1.3: Statusi i punësimit

Në vitin 2016, 70.0% e personave të punësuar ishin punonjës, 7.2% ishin të vetë-punësuar dhe kishin punonjës të tjerë, 15.0% ishin të vetë-punësuar pa punonjës të tjerë dhe 7.9% ishin punëtorë familjarë (Tabela 1.4). Shumica e femrave të punësuar kishin statusin e punonjës (77.9% krahasuar me 67.7% për meshkujt).

Tab. 1.4: Statusi i punësimit sipas gjinisë (%)

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Statusi i Punësimit (%)			
Punonjës	67.7	77.9	70.0
I vetë-punësuar me punonjës	8.3	3.2	7.2
I vetë-punësuar pa punonjës	15.9	11.8	15.0
Punëtor familjar i papaguar	8.1	7.1	7.9
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

1.4: Punësimi i paqëndrueshëm

Përveç shkallës së ulët të punësimit në Kosovë, 22.9% e personave të punësuar punonin në vende pune të paqëndrueshme. Punëtorët në punë të paqëndrueshme janë ose persona të vetëpunësuar pa punonjës, ose ata që punojnë pa pagesë në një biznes familjar. Këto dy grupe punëtorësh kanë gjasat më të pakta të kenë një marrëveshje formale pune në krahasim me punëtorët me pagesë dhe rrogë.

Meshkujt kanë më shumë gjasa të mbajnë punë të tilla të paqëndrueshme (24.1% e meshkujve të punësuar krahasuar me 18.8% të femrave të punësuar). Shprehur në numra absolutë, 75,963 nga 331,761 të punësuar i përkasin kategorisë së

punësimi të paqëndrueshëm (Tabela 1.5). Të punësuarit në fusha profesionale kanë më pak gjasa të jenë të punësuar në punë të paqëndrueshme (Tabela 1.6), si dhe personat me nivel të lartë arsimimi (Tabela 1.7).

Tab. 1.5: Punësimi i paqëndrueshëm sipas gjinisë

Kosovë	
PUNËSIM I PAQËNDRUESHËM (NË MIJËRA)	
Meshkuj	62.0
Femra	14.0
Të gjithë	76.0
PËRQINDJA E PUNËSIMIT TË PAQËNDRUESHËM NË PUNËSIMITIN E PËRGJITHSHËM (%)	
Meshkuj	24.1
Femra	18.8
Të gjithë	22.9

Tab. 1.6: Punësimi i paqëndrueshëm sipas profesionit dhe gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
TË VETËPUNËSUAR PA PUNONJËS TË TJERË (%)			
Ligjvënës, zyrtarë dhe menaxherë të lartë	2.4	0.0	2.0
Profesionistë	1.7	0.6	1.5
Teknikë dhe profesione të lidhura me ta	2.5	0.2	2.1
Nëpunës	0.5	0.7	0.5
Punëtorë shërbyes dhe punëtorë shitës në dyqane dhe tregje	17.9	16.7	17.7
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	9.5	1.0	8.0
Punëtorë zejtarie dhe të ngjajshëm me ta	22.9	73.0	31.7
Operatorë fabrikash dhe makinerish dhe montues	11.5	0.5	9.6
Profesione elementare	31.0	7.3	26.9
Gjithsej	100.0	100.0	100.0
PUNËTORË FAMILJARË TË PAPAGUAR (%)			
Ligjvënës, zyrtarë dhe menaxherë të lartë	3.4	3.6	3.5
Profesionistë	1.6	4.5	2.2
Teknikë dhe profesione të lidhura me ta	0.5	2.3	0.9
Nëpunës	0.2	0.0	0.1
Punëtorë shërbyes dhe punëtorë shitës në dyqane dhe tregje	20.3	39.4	24.1
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	7.2	3.7	6.5
Punëtorë zejtarie dhe të ngjajshëm me ta	23.3	3.2	19.3
Operatorë fabrikash dhe makinerish dhe montues	4.7	0.0	3.8
Profesione elementare	38.8	43.3	39.7
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

Tab. 1.7: Punësimi i paqëndrueshëm sipas nivelit arsimor dhe gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
TË VETËPUNËSUAR PA PUNONJËS TË TJERË (%)			
Pa shkollë	0.4	4.3	1.1
Fillor	32.0	67.3	38.2
Arsim i mesëm profesional	33.3	14.8	30.1
Shkollë e mesme gjimnazi	27.5	12.3	24.9
Terciar	6.8	1.4	5.8
Gjithsej	100.0	100.0	100.0
PUNËTORË FAMILJARË TË PAPAGUAR (%)			
Pa shkollë	0.3	0.0	0.2
Fillor	32.2	51.3	36.0
Arsim i mesëm profesional	37.5	28.5	35.7
Shkollë e mesme gjimnazi	23.6	15.0	21.9
Terciar	6.4	5.3	6.2
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

1.5: Llojet e kontratave

Për sa i përket llojit të kontratës, që kishin të punësuarit e intervistuar, shumica (73.7%) kishin një kontratë individuale, ndërsa pjesa tjetër punonin pa kontratë. Për të rinjtë e moshës (15 deri 24 vjeç), përqindja e atyre që punonin pa kontratë ishte 54.8 %.

Nga personat, që kishin kontratë pune, vetëm 29.5% kishin një kontratë të përhershme për punën e tyre kryesore, ndërsa 70.5% kishin kontrata të përkohshme. Shifrat janë të ngjashme për meshkujt dhe femrat. Personat, që kishin kontrata të përkohshme, u pyetën se pse ata kishin këtë lloj kontrate dhe 98.5% e të intervistuarve raportuan se nuk kishte asnjë lloj tjetër kontrate në dispozicion.

Kur u pyetën nëse kishin të drejtë, në punën e tyre kryesore, të përfitimit nga një skeme e sigurimeve sociale në punë, të dhënat nga anketa treguan se vetëm 3.6 % e punonjësve e kishin këtë të drejtë.

1.6: Punësimi sipas aktiviteteve

Tregtia, prodhimi, ndërtimtaria dhe arsimit punësonin më shumë se gjysmën e personave të punësuar në vitin 2016 (tabelat 1.8 dhe 1.9). Tregtia punësonte 14.8%, duke vazhduar me prodhimin 13.2%, ndërtimtarinë 11.5% dhe arsimit 10.6 % të personave të punësuar në Kosovë.

Arsimi, tregtia dhe kujdesi shëndetësor ishin tre punëdhënësit kryesorë për femrat (duke punësuar 51.3% të femrave të punësuar). Prodhimi, ndërtimtaria dhe tregtia janë sektorët më të zakonshëm të punësimit për meshkujt (duke punësuar 44.3% të meshkujve të punësuar).

Tab. 1.8: Punësimi sipas aktiviteteve dhe gjinisë (në mijëra)

Kosovë (mosha 15 e më shumë)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Bujqësi, pylltari dhe peshkim	12.5	1.7	14.2
Minierat dhe xehoret	3.6	0.0	3.6
Prodhimi	39.9	4.3	44.2
Furnizimi me elektricitet, gaz, avull dhe klimatizim	5.3	0.2	5.5
Furnizimi me ujë, ujërat e zeza, menaxhim i mbetjeve	6.1	0.7	6.7
Ndërtimtari	38.2	0.4	38.6
Tregti me shumicë dhe pakicë, riparime automjetesh dhe motoçikletash	36.8	12.8	49.5
Transport dhe depozitim	9.8	0.8	10.6
Aktivitete akomodimi dhe shërbimesh ushqimi	18.5	2.8	21.3
Informim dhe komunikim	5.5	1.8	7.3
Aktivitete financiare dhe sigurimesh	4.3	2.2	6.5
Aktivitete me prona të paluajtshme	0.3	0.0	0.3
Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	5.0	1.7	6.6
Aktivitete administrative dhe shërbime mbështetëse	9.2	1.8	11.0
Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social	19.3	5.5	24.8
Arsimi	20.1	15.3	35.4
Aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe punës sociale	8.5	10.3	18.8
Arti, zbavitja dhe rekreacioni	3.8	1.8	5.6
Aktivitete të shërbimeve të tjera	8.9	3.2	12.1
Aktivitete të punësimit shtëpiak	2.0	6.6	8.6
Aktivitete të institucioneve dhe organizatave jashtë-territoriale	2.0	1.0	3.0
Gjithsej	259.4	74.8	334.2

Tab. 1.9: Punësimi sipas aktiviteteve dhe gjinisë (në %)

Kosovë (mosha 15 e më shumë)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Bujqësi, pylltari dhe peshkim	4.8	2.3	4.2
Minierat dhe xehoret	1.4	0.0	1.1
Prodhimi	15.4	5.8	13.2
Furnizimi me elektricitet, gaz, avull dhe klimatizim	2.1	0.2	1.6
Furnizimi me ujë, ujërat e zeza, menaxhim i mbetjeve	2.3	0.9	2.0
Ndërtimtari	14.7	0.5	11.5
Tregti me shumicë dhe pakicë, riparime automjetesh dhe motoçikletash	14.2	17.1	14.8
Transport dhe depozitim	3.8	1.1	3.2
Aktivitete akomodimi dhe shërbimesh ushqimi	7.1	3.8	6.4
Informim dhe komunikim	2.1	2.5	2.2
Aktivitete financiare dhe sigurimesh	1.7	2.9	1.9
Aktivitete me prona të paluajtshme	0.1	0.0	0.1
Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	1.9	2.2	2.0
Aktivitete administrative dhe shërbime mbështetëse	3.5	2.4	3.3
Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social	7.4	7.3	7.4
Arsimi	7.7	20.5	10.6
Aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe punës sociale	3.3	13.8	5.6
Arti, zbavitja dhe rekreacioni	1.5	2.4	1.7
Aktivitete të shërbimeve të tjera	3.4	4.3	3.6
Aktivitete të punësimit shtëpiak	0.8	8.8	2.6
Aktivitete të institucioneve dhe organizatave jashtë-territoriale	0.8	1.3	0.9
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

1.7: Punësimi sipas profesioneve

Në vitin 2016, shumica e të punësuarve kishin pozita pune në shërbime dhe shitje, në profesione elementare, si profesionistë dhe si punëtorë zejtarie (Tabela 1.10).

Pothuaj gjysma e femrave të punësuarra ishin profesioniste, teknike dhe profesione që lidhen me to (39.9%), 18.1% ishin në shërbime dhe shitje dhe 14.6% në profesione elementare. Meshkujt ishin më të shpërndarë nëpër sektorë, por shumica ishin të punësuar në profesione elementare (24.1%), 18.0% punonin si punonjës në shërbime dhe shitje, 17.6% si punëtor zejtarie dhe të ngjashëm me të kurse 9.7% ishin profesionistë (Tabela 1.10).

Tab. 1.10: Punësimi sipas profesioneve dhe gjinisë (në %)

Kosovë (mosha 15 e më shumë)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PUNËSIMI SIPAS PROFESIONEVE (NË MIJËRA)			
Ligjvënës, zyrtarë dhe menaxherë të lartë	22.1	3.5	25.5
Profesionistë	25.1	21.0	46.2
Teknikë dhe profesione të lidhura me ta	15.9	8.8	24.7
Nëpunës	11.6	6.7	18.4
Punëtorë shërbyes dhe punëtorë shitës në dyqane dhe tregje	46.8	13.6	60.4
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	7.1	0.3	7.4
Punëtorë zejtarie dhe të ngjashëm me ta	45.8	9.1	54.9
Operatorë fabrikash dhe makinerish dhe montues	22.4	0.8	23.2
Profesione elementare	62.6	10.9	73.5
Gjithsej	259.4	74.8	334.2
PUNËSIMI SIPAS PROFESIONEVE (NË %)			
Ligjvënës, zyrtarë dhe menaxherë të lartë	8.5	4.6	7.6
Profesionistë	9.7	28.1	13.8
Teknikë dhe profesione të lidhura	6.1	11.8	7.4
Nëpunës	4.5	9.0	5.5
Punëtorë shërbyes dhe punëtorë shitës në dyqane dhe tregje	18.0	18.1	18.1
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	2.7	0.4	2.2
Punëtorë zejtarie dhe të ngjashëm me ta	17.6	12.2	16.4
Operatorë fabrikash dhe makinerish dhe montatorë	8.6	1.1	6.9
Profesione elementare	24.1	14.6	22.0
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

*Profesionet elementare përfshijnë pastrues dhe ndihmës, punëtorë të bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit, punëtorë të minierave, ndërtimit, prodhimit industrial, transportit, asistentë të përgatitjes së ushqimit, punëtorë të shitjeve në rrugë, punëtorët e pastrimit të mbetjeve urbane dhe punëtorë të tjerë elementarë (ISCO 88 COM).

1.8: Modelet e punës

Vetëm 0.8 % e popullsisë së punësuar kanë raportuar se kishin një punë të dytë gjatë javës referente.

Në punën e tyre kryesore, 94.0 % e të intervistuarve raportuan se punojnë me orar të plotë dhe 6.0% me orar të pjesshëm/orar të shkurtuar. Janë vërejtur dallime gjinore, me më shumë gjasa që femrat të punojnë me orar të pjesshëm (11.7% krahasuar me 4.4%).

Për ata që bëjnë punë me orar të pjesshëm, arsyet dallonin midis dy gjinive, gratë marrin një rol më të madh kujdesi brenda familjes duke reduktuar kështu orët në dispozicion për të punuar (Tabela 1.11). Arsyeja numër një për meshkujt pse nuk punojnë me orar të plotë, ishte mungesa e disponueshmërisë së punës me orar të plotë.

Tab. 1.11: Arsyet e të punuarit me orar të pjesshëm sipas gjinisë (%)

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Kujdesi për fëmijët apo të rriturit me aftësi të kufizuar	0.0	0.6	0.2
Invalitetet ose sëmundje	0.3	0.0	0.2
Arsye të tjera personale ose familjare	0.3	68.5	28.2
Vazhdon shkollimin ose trajnimin	9.2	7.2	8.4
Nuk ka mundësi të gjejë punë me orar të plotë	82.1	18.1	56.0
Nuk dëshiron një punë me orar të plotë	0.7	2.0	1.2
Arsye tjetër	7.4	3.7	5.9
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

Përafërsisht tri të pestat e të punësuarve kanë punuar midis 40-48 orë në javë. Pothuajse dy të dhjetat (15.9%) e të punësuarve kanë punuar 60 ose më shumë orë në javë. Brenda një jave, 16.8 % e të punësuarve kanë punuar më pak se 40 orë.

Meshkujt priren të punojnë me orare më të gjata se femrat, 29.9 % e meshkujve punojnë më shumë se 48 orë në javë krahasuar me 9.9 % të femrave (Tabela 1.12). Një pjesë më e madhe e femrave të punësuarra (25.9%) ka punuar më pak se 40 orë në krahasim me 14.2 % e meshkujve.

Tab. 1.12: Punësimi sipas orëve të punës në javë dhe sipas gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PUNËSIMI SIPAS NUMRIT TË ORËVE (NË MIJËRA)			
Më pak se 25	22.2	14.0	36.3
25-34	12.3	4.5	16.8
35-39	2.0	0.7	2.7
40-48	143.9	47.7	191.6
49-59	27.8	3.6	31.5
60 e më shumë	49.1	3.7	52.9
Gjithsej	257.4	74.4	331.8
PUNËSIMI SIPAS NUMRIT TË ORËVE (NË %)			
Më pak se 25	8.6	18.9	10.9
25-34	4.8	6.1	5.1
35-39	0.8	0.9	0.8
40-48	55.9	64.2	57.8
49-59	10.8	4.9	9.5
60 e më shumë	19.1	5.0	15.9
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

Të intervistuarit, që punojnë në sektorin publik, kanë raportuar orar më të shkurtër të punës se ata në sektorin privat (Tabela 1.13). Meshkujt dhe femrat, që punojnë në kompani private, kanë punuar me orare më të gjata krahasuar me të gjitha llojet e punësimit.

Tab. 1.13: Numri mesatar i orëve të punuara në javë sipas llojit të punëdhënësit dhe gjinisë

Kosovë	Spektori publik, qeveria	Ndërmarrje në pronësi shtetërore	Kompani private	Individuale private
Meshkuj	37 orë	39 orë	48 orë	45 orë
Femra	34 orë	34 orë	43 orë	42 orë
Gjithsej	36 orë	38 orë	47 orë	44 orë

Gjasat janë më të vogla që femrat të punojnë me ndërrime, gjatë ndërrimeve të natës, mbrëmjeve dhe fundjavave por pak më të mëdha që të punojnë nga shtëpia (Tabela 1.14).


Tab. 1.14: Modelet e punësimit sipas gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
NËSE PUNON ME NDËRRIME			
Punon me ndërrime	22.6	17.0	21.2
Nuk punon me ndërrime	77.4	83.0	78.8
Gjithsej	100.0	100.0	100.0
NËSE PUNON MBRËMJEVE			
Zakonisht	15.0	12.1	14.3
Ndonjëherë	29.3	19.3	27.1
Kurrë	55.7	68.6	58.6
Gjithsej	100.0	100.0	100.0
NËSE PUNON NATËN			
Zakonisht	2.7	0.3	2.2
Ndonjëherë	12.0	6.7	10.8
Kurrë	85.3	93.0	87.0
Gjithsej	100.0	100.0	100.0
NËSE PUNON TË SHTUNAVE			
Zakonisht	40.8	29.9	38.3
Ndonjëherë	35.2	22.2	32.3
Kurrë	24.0	47.9	29.4
Gjithsej	100.0	100.0	100.0
NËSE PUNON TË DIELAVE			
Zakonisht	9.6	14.5	10.7
Ndonjëherë	30.4	14.0	26.7
Kurrë	60.0	71.5	62.6
Gjithsej	100.0	100.0	100.0
NËSE PUNON NË SHTËPI			
Zakonisht	4.3	10.2	5.7
Ndonjëherë	15.8	15.6	15.7
Kurrë	79.9	74.2	78.6
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

1.9: Paga mujore neto

Shumica e pagave mujore neto ishin midis 300 € dhe 400 €, në mesin e atyre që u përgjigjën. Janë vërejtur dallime shumë të vogla gjinore, me një tendencë të lehtë që meshkujt të marrin paga më të larta

Graf. 1.2: Paga mujore neto për punonjësit sipas gjinisë




2. Papunësia

2.1: Papunësia sipas gjinisë

Sipas vitit 2016 në Kosovë ka pasur 126,070 persona të moshës 15-64 vjeç, që ishin të papunë, 91,366 nga të cilët ishin meshkuj dhe 34,704 femra (Tabela 2.1). Shkalla e papunësisë ishte 27.5 %, më e lartë për femra se për meshkuj, respektivisht 31.8 % dhe 26.2 % (Graf. 2.1).

Krahasuar me AFP-së të vitit 2015 në Kosovë, kemi rënie të shkallës së papunësisë me 5.4%, ku kjo rënie te meshkujt ishte 5.6% përderisa te femrat kemi rënie prej 4.8%.

Graf. 2.1: Shkalla e papunësisë sipas gjinisë



Tab. 2.1: Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PAPUNËSIA (NË MIJËRA)			
15-64	91.4	34.7	126.1
SHKALLA E PAPUNËSISË (%)			
15-64	26.2	31.8	27.5

2.2: Papunësia sipas grup moshës dhe nivelit arsimor

52.4 % e popullsisë së re në Kosovë ishin të papunë (Tabela 2.2). Shkalla më e ulët e papunësisë është hasur në mesin e personave të moshës 55-64 vjeç (12.3%).

Tab. 2.2. Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas gjinisë dhe grup moshës

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PAPUNËSIA (NË MIJËRA)			
15-24	24.8	13.5	38.3
25-34	30.7	13.5	44.1
35-44	18.3	5.5	23.8
45-54	11.8	1.7	13.5
55-64	5.8	0.5	6.4
15-64	91.4	34.7	126.1
SHKALLA E PAPUNËSISË (%)			
15-24	47.2	65.4	52.4
25-34	32.3	40.1	34.3
35-44	21.4	21.6	21.4
45-54	16.3	8.1	14.5
55-64	13.4	6.5	12.3
15-64	26.2	31.8	27.5

Shkalla e papunësisë ishte më e larta për personat e pashkolluar (47.2% e këtij grupi ishin të papunë) dhe më e ultë për personat që kishin përfunduar arsimin e lartë (18.0%).

Tabela 2.3. Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas nivelit arsimor dhe gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PAPUNËSIA (NË MIJËRA)			
Pa shkollë	0.6	0.1	0.7
Fillor	24.2	4.7	29.0
Arsim profesional i mesëm	42.0	12.2	54.2
Shkollë e mesme gjimnazi	17.2	6.2	23.4
Terciar	7.4	11.4	18.8
Totali	91.4	34.7	126.1
SHKALLA E PAPUNËSISË (%)			
Pa shkollë	62.9	19.5	47.2
Fillor	34.5	25.2	32.6
Arsim profesional i mesëm	31.1	38.8	32.5
Shkollë e mesme gjimnazi	21.7	35.7	24.3
Terciar	11.6	28.0	18.0
Totali	26.2	31.8	27.5

Shkollimi ka përmirësuar perspektivat në tregun e punës, në veçanti për meshkujt pasi 62.9 % e meshkujve të pashkolluar ishin të papunë, në krahasim me 11.6 % të atyre që kishin përfunduar arsimin terciar.

2.3: Papunësia tek të rinjtë

Bazuar në AFP-në e vitit 2016, 30.4% e të papunëve në Kosovë ishin të rinj (të moshës 15-24 vjeç) me pothuajse 12 pikë diferencë midis meshkujve dhe femrave.

Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së re është e papunë (52.4%) dhe shkalla e papunësisë tek rinia e gjinisë femërore është më e lartë (65.4 %) krahasuar me meshkujt (47.2%).

Tab. 2.4: Përqindja e të rinjve të papunë në papunësinë e përgjithshme dhe shkalla e papunësisë tek të rinjtë sipas gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Përqindja e të rinjve të papunë në papunësinë e përgjithshme (%)	27.2	38.9	30.4
Përqindja e të rinjve si të papunë në popullsinë e re (%)	47.2	65.4	52.4

Në vitin 2016, të rinjtë në Kosovë kishin dy herë më shumë gjasa të ishin të papunë në krahasim me të rriturit, me shifra pothuajse të ngjashme për meshkujt dhe femrat (Tabela 2.5).

Tab. 2.5: Shkalla e papunësisë së të rinjve ndaj të rriturve, sipas gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Shkalla e papunësisë së të rinjve ndaj papunësisë së të rriturve	2.1	2.7	2.3

2.4: Kohëzgjatja e papunësisë


Të intervistuarit e papunë janë pyetur për sa kohë janë të papunë. Një numër i madh (65.5%) i te papunëve raportuan se janë të papunë për më gjatë se 12 muaj. Janë vërejtur dallime të vogla gjinore (65.6% e meshkujve dhe 65.0% e femrave). (Tabela 2.6) tregon se gjasat për të qenë i/e papunë për më shumë se një vit rriten me moshën.

Tabela 2.6: Kohëzgjatja e papunësisë për më shumë se një vit sipas grup moshës dhe gjinisë (%)

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
15-19	35.6	47.4	39.7
20-24	52.1	57.8	54.1
25-29	67.9	64.6	66.8
30-34	69.6	71.2	70.0
35-39	66.3	75.5	68.5
40-44	74.6	78.1	75.3
45-49	74.4	88.2	76.6
50-54	81.0	88.9	81.7
55-59	82.0	47.0	78.9
60-64	93.1	100.0	93.6
Gjithsej	65.6	65.0	65.5

Grafikoni 2.2, tregon se grup moshë 30-34 edhe pse grup moshë e re, te femrat papunësia për më shumë se një vit arrin 71.2% krahasuar me 69.6% te meshkujt.

Graf. 2.2. Kohëzgjatja e papunësisë për më shumë se një vit sipas grup moshës dhe gjinisë (%)




3. Pjesëmarrja në fuqinë punëtore

Në vitin 2016, nga popullsia e përgjithshme e përlogaritur prej 1,771,604, popullsia e përgjithshme në moshë pune (15 deri 64 vjeç) ishte 1,184,529 persona. 38.7% e personave në moshë pune merrnin pjesë në fuqinë punëtore (ekonomikisht aktivë). Kjo do të thotë se ata ishin ose të punësuar ose të papunë (por aktivë në kërkim të një pune dhe të gatshëm për punë). Pjesa tjetër prej 61.3% ishin ekonomikisht joaktivë (Graf. 4.1). Personat ekonomikisht joaktivë përfshijnë studentët, amviset, punonjësit e dekurajuar dhe persona të tjerë, të cilët nuk ishin aktivë në kërkim të një pune dhe kjo kategori shqyrtohet më hollësisht në kapitullin e ardhshëm.

Krahasuar me AFP-së e vitit 2015 në Kosovë, kemi rritje të shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore me 1.1 %, ku kjo rritje te meshkujt ishte 1.6 % përderisa te femrat ishte vetëm 0.5 %.

Graf. 3.1: Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas gjinisë



Nga figura 3.1 është e qartë se pjesëmarrja në fuqinë punëtore në mesin e femrave ishte shumë më e ulët se në mesin e meshkujve: 18.6 % e femrave ishin aktive në krahasim me 58.3 % e meshkujve.

Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ishte më e larta në mesin e personave të moshës 30-34 vjeç (52.5 %) dhe më e ulët në mesin e personave të moshës 15 deri 19 vjeç me 9.2 % (Tabela 3.1). Shkalla e ulët e pjesëmarrjes së të rinjve nuk është për t'u habitur sepse shumica e këtij grupi ndjekin shkollën.

Tek meshkujt, moshat 45-49 vjeç kishin shkallë më të lartë pjesëmarrjeje (79.9 %), ndërsa për femrat shkalla më e lartë ishte në grup moshën, 25-29 vjeç (28.5 %) (Tabela 3.1).

Tab. 3.1: Fuqia punëtore dhe shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas gjinisë dhe grupmoshës

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Fuqia Punëtore (në mijëra)			
15-19	12.1	4.6	16.7
20-24	40.4	16.1	56.5
25-29	50.7	17.7	68.4
30-34	44.3	15.9	60.2
35-39	41.7	12.8	54.5
40-44	43.8	12.7	56.4
45-49	38.6	12.5	51.1
50-54	33.5	8.7	42.1
55-59	26.9	5.1	32.0
60-64	16.7	3.2	19.9
Totali 15 - 64	348.8	109.1	457.8
Shkalla e Pjesëmarrjes në Fuqinë Punëtore (%)			
15-19	12.8	5.3	9.2
20-24	46.3	21.1	34.5
25-29	67.9	28.5	50.0
30-34	75.5	28.3	52.5
35-39	77.6	21.9	48.5
40-44	79.7	21.3	49.3
45-49	79.9	22.1	48.8
50-54	67.8	16.2	41.0
55-59	65.1	11.6	37.6
60-64	47.5	9.5	28.8
Totali 15 - 64	58.3	18.6	38.7


4. Personat joaktivë

Vëmendje e veçantë i është kushtuar përshkrimit dhe vlerësimit të popullsisë së punësuar dhe asaj të papunë, që së bashku përbëjnë Fuqinë Punëtore (ose personat ekonomikisht aktivë). Megjithatë, kategoria “joaktivë” është po aq e rëndësishme. Ndryshimet në shkallën e aktivitetit janë pjesë e rëndësishme e ndikimit të ofertës së punës në rritjen potenciale ekonomike. Kjo për shkak të numrit të madh të punëtorëve potencialë në mesin e personave aktualisht joaktivë.

Krahasuar me AFP-së e vitit 2016 në Kosovë, kemi rënie të shkallës së jo aktivitetit me 1.1%, ku kjo rënie te meshkujt ishte 1.6% përderisa te femrat ishte vetëm 0.5%.

Nga graf. 4.1 është e qartë se pjesëmarrja më e madhe është në mesin e femrave se në mesin e meshkujve: 81.4% e femrave ishin jo aktive në krahasim me 41.7% e meshkujve.

Graf 4.1: Shkalla e pjesëmarrjes jo aktive sipas gjinisë



4.1: Të rinjtë joaktivë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollimin ose trajnim (NEET)

Të rinjtë e këtij grupi (NEET) përfshijnë të rinjtë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollën, as nuk trajnohen, d.m.th. janë krejtësisht të shkëputur nga tregu i punës dhe nuk marrin pjesë as në sistemin arsimor. Përqindjet e larta të këtij grupi në popullsinë e të rinjve rrisin shqetësimet në lidhje me punësimin e të rinjve në të ardhmen pasi tregon shkëputje nga tregu i punës. Përveç kësaj, një numër i madh i të rinjve të pa angazhuar në vendet me papunësi të lartë të të rinjve, siç është Kosova, mund të shkaktojë uljen e fitimeve për shkak të rritjes së konkurrencës, si dhe ka mundësi t'i kontribuojë problemeve sociale.

Në vitin 2016, 103,843 të rinj (të moshës 15 deri 24) në Kosovë nuk ndiqnin shkollimin, nuk ishin të punësuar apo në trajnim dhe përbënin 30.1 % të popullsisë së re. Pjesa e femrave NEET është 34.2% krahasuar me 26.5% të meshkujve (Tabela 4.2).

Tab 4.1: Të rinj që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollë ose trajnim (NEET) sipas gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Të rinj NEET (në mijëra)	48.3	55.6	103.8
Përqindja e të rinjve NEET në popullsinë e re (%)	26.5	34.2	30.1

5. Shkallët e varësisë demografike dhe ekonomike

Në Tabelën 5.1 janë paraqitur tri shkallë të varësisë ekonomike (me të dhënat e paraqitura si përqindja e të varurve për 100 nga popullsia në moshë pune):

- Shkalla e varësisë së të rinjve (të intervistuarit e moshës nën 15/të intervistuarit e moshës 15-64)
- Shkalla e varësisë së të moshuarve (të intervistuarit e moshës 65+/ të intervistuarit e moshës 15-64)
- Shkalla e varësisë moshore (të intervistuarit më të rinj se 15 ose më të vjetër se 64/ të intervistuarit e moshës 15-64).

Tab 5.1: Shkallët e varësisë demografike

Kosovë 2016	Shkalla e varësisë së të rinjve	Shkalla e varësisë së të moshuarve	Shkalla e varësisë moshore
2016	36%	14%	50%

Një shkallë tjetër e përdorur shpesh, në veçanti në publikimet e Eurostat-it, është shkalla e varësisë efektive ekonomike e të moshuarve. Ky është një indikator i rëndësishëm për vlerësimin e ndikimit potencial të moshës së shtyrë në shpenzimet sociale, që lidhen me punësimin (pensionet etj.). Ky indikator kalkulohet si raport midis popullsisë së moshës 65+ (të gjithë të klasifikuar si joaktivë) dhe punësimit të përgjithshëm. Për këtë raport Eurostat-i ka vendosur gamën e moshës për të punësuarit nga 20 deri në 64 vjeç. Sipas projeksioneve, ky indikator do të rritet në 68 % në vitin 2060 në BE28. Në Kosovë ky raport ishte 50 % për vitin 2016.

Tab 5.2: Shkallët e varësisë ekonomike

Kosovë 2016	Shkalla e varësisë efektive ekonomike e të moshuarve	Shkalla totale e varësisë ekonomike
2016	51%	274%

Shkalla totale e varësisë ekonomike kalkulohet si raport midis popullsisë së përgjithshme joaktive (15+) dhe punësimit (20-64 vjeç). Ai mat numrin mesatar të personave të moshës 15 vjeç e më shumë, që "përkrah" secili i punësuar. Ky raport ishte 274% në vitin 2016. Sipas projeksioneve deri në vitin 2023 ky raport do të vazhdojë të rritet në BE, në 122.2% në vitin 2023 dhe 141.6 % në vitin 2060.

